



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 303/8 Prot.



Shkodër, më 11/05/2026

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- Vendimin Administrativ Nr.303/6prot., datë 14.04.2026 i Degës së Doganës Shkodër për subjektin NEFFER sh.p.k me NIPT M27227003J.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës Shkodër

Nr. 303/ Prot.
16

Shkodër, më 14/04/2026

V E N D I M
Nr.22 datë 14.04.2026

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganës Shkodër, mori në shqyrtim, shkresën nr. 303 prot., datë 27.01.2026 Program kontrolli, nr. 303/1 prot, datë 04.02.2026 Lenda: Informacion mbi program kontrollin, dhe shkresën nr. 303/2prot., datë 05.03.2026, lënda: Informacion, proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore nr.303/3 datë 05.03.2026 të mbajtur nga doganieret e Zyrës së Regjimeve pranë Degës së Doganës Shkodër, lidhur me konstatimet e bëra për subjektin **“NEEFER” SHPK, me NIPT M27227003J, me administrator ANTONIETTA ZIPPO**, me adresë: Shkodër Lgj. Skenderbeg, Rr. Inxh Gjovalin Gjadri, zona kadastrale 8592, nr. pasurie 10/26+2+1, Telefon: 0673448765.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe procesverbalit të mësipërm, si dhe të Autorizimeve për Regjimin e Përpunimit Aktiv nr. 17708/1, datë 25.01.2023 dhe nr. 28714/1, datë 23.01.2024, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, rezulton se:

Subjekti **“NEEFER” sh.p.k.**, me NIPT M27227003J, ka ushtruar aktivitet nën regjimin e përpunimit aktiv, në përputhje me përcaktimet e këtyre autorizimeve, bazuar në Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 **“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019.

Dega Doganore Shkodër, nëpërmjet grupit të kontrollit, ka kryer kontroll sipas programit të kontrollit nr. 303 prot., datë 27.01.2026.

Grupi i kontrollit është paraqitur pranë ambienteve të subjektit në datë 27.01.2026, por përfaqësuesi i subjektit ka deklaruar se nuk dispononte çelësat e ambientit. Kontrolli është vijuar në datë 28.01.2026, ora 11:30, ku sipas grupit të kontrollit përsëri ambienti rezultoi i mbyllur. Jashtë ambienteve u konstatuan mallra, konkretisht:

- lëndë e parë (pëlhurë) në sasi 14 rrotulla, me peshë 92.4 kg;
- materiale ndihmëse (këmisha të qepura), 132 copë, me peshë totale 92.4 kg.

Në total u konstatuan 296.4 kg mall. Sipas akt-rakordimit, rezulton një diferencë prej 139.27 kg.

Për autorizimin nr. 17708/1, datë 25.01.2023:

Importet janë kryer në periudhën 12.08.2023 – 27.07.2024, me vlerë 551,620 euro dhe peshë 30,777 kg. Eksportet janë realizuar në periudhën 04.08.2023 – 22.07.2024, në sasi 51,806 copë, me vlerë 542,745 euro dhe peshë 26,022 kg. Është kryer gjithashtu një import me procedurë 9 me peshë 4,319 kg.

Si pasojë, rezulton mall i pa eksportuar me diferencë në vlerë 8,875 euro dhe peshë 435 kg.

Bazuar në nenin 550 të VKM-së Nr. 651, datë 10/11/2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr.04 datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin e mbylljes së regjimit, i cili sipas konstatimeve të doganieres mbikëqyrëse të regjimit duhet të ishte data 23.08.2025.

Nga verifikimet e kryera nga zyra e mbikëqyrjes doganore, rezulton se subjekti nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga regjimi i përpunimit aktiv, konkretisht:

- ❖ mosdhënia e destinacionit doganor për mallrat e vendosura në RPA, rezulton mall i pa eksportuar me diferencë në vlerë 8,875 euro dhe peshë 435 kg
- ❖ mosparaqitja e dokumentacionit për mbylljen e regjimeve doganore brenda afateve të përcaktuara.

Veprimet dhe mosveprimet e subjektit “NEEFER” sh.p.k., me NIPT M27227003J, në lidhje me mosdhënies së destinacion të mallrave të vendosur në regjimin e përpunimit aktiv “produkt i gatshëm” dhe “mbetje teknologjike”, janë në kundërshtim me nenin 195, pikat 1 dhe 4 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Neni 195 – Mbyllja e një regjimi të posaçëm

1. Në raste të ndryshme nga regjimi i transitit dhe pa cenuar nenin 227, një regjim i posaçëm mbyllet kur mallrat e vendosura nën regjim ose produktet e përpunuara janë vendosur në një regjim doganor pasues, janë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose janë shkatërruar pa lënë mbetje, apo janë braktisur në favor të shtetit, në përputhje me nenin 180.
2. Mbyllja e regjimit bëhet brenda afatit kohor të përcaktuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.”

Gjithashtu, këto veprime bien në kundërshtim me nenet 537 deri në nenin 550 të VKM-së Nr. 651, datë 10/11/2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, si dhe me Udhëzimin nr. 04, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Sipas përlllogaritjeve të kryera nga zyra e mbikëqyrjes doganore, rezulton se për mallin (produkt i gatshëm), të cilit nuk i është dhënë destinacion doganor brenda afateve ligjore, vlera është 8,875 euro, **përbën detyrimi doganor të shmangur në shumën 170,400 lekë.**

Për autorizimin nr. 28714/1, datë 23.01.2024:

Importet janë kryer në periudhën 31.01.2024 – 28.11.2024, me vlerë 213,533 euro dhe peshë 13,115 kg. Eksportet janë realizuar në periudhën 05.03.2024 – 25.02.2025, në sasi 19,648 copë, me vlerë 214,200 euro dhe peshë 15,598 kg. Është kryer gjithashtu një import me procedurë 9 me peshë 262 kg. Afati i fundit për përmbushjen e detyrimeve në sistem ka qenë data 25.01.2026.

Nga verifikimet e kryera nga zyra e mbikëqyrjes doganore, rezulton se subjekti nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga regjimi i përpunimit aktiv, konkretisht:

- ❖ moskryerja e procedurave IM9 për sistemimin përfundimtar të mbetjeve të dala nga procesi teknologjik, rezulton që subjekti të ketë mbetje pa i dhënë destinacion doganor

- për këtë regjim **në peshën 1225 kg.**
- ❖ mosparaqitja e dokumentacionit për mbylljen e regjimeve doganore brenda afateve të përcaktuara.

Veprimet dhe mosveprimet e subjektit “NEEFER” sh.p.k., me NIPT M27227003J për mosdhënies së destinacion të mallrave të vendosur në regjimin e përpunimit aktiv “mbetje teknologjike”, bien në kundërshtim me nenin 195, pikat 1 dhe 4 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Neni 195 – Mbyllja e një regjimi të posaçëm

3. Në raste të ndryshme nga regjimi i transitit dhe pa cenuar nenin 227, një regjim i posaçëm mbyllet kur mallrat e vendosura nën regjim ose produktet e përpunuara janë vendosur në një regjim doganor pasues, janë nxjerrë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose janë shkatërruar pa lënë mbetje, apo janë braktisur në favor të shtetit, në përputhje me nenin 180.
4. Mbyllja e regjimit bëhet brenda afatit kohor të përcaktuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.”

Gjithashtu, këto veprime bien në kundërshtim me nenet 537 deri në nenin 550 të VKM-së Nr. 651, datë 10/11/2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, si dhe me Udhëzimin nr. 04, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Sipas përlogaritjeve të kryera nga zyra e mbikëqyrjes doganore, rezulton se për mallin (mbetje nga përpunimi), në sasi 1,225 kg, **përbën detyrimi doganor të shmangur në shumën 47,040 lekë.**

Mallrat e vendosura nën regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) përfitojnë pezullim nga detyrimet doganore dhe pagesat e tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe masat e politikës tregtare, duke i dhënë operatorëve ekonomikë një status të privilegjuar në operacionet doganore.

Në këtë kuadër, veprimet dhe mosveprimet e subjektit mos dhënia destinacion i mallrave në regjimin e RPA-së si të produkteve të gatshme dhe mbetjeve teknologjike, i cili nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga ky regjim favorizues, duke mos përmbushur kërkesat procedurale ligjore dhe duke sjellë si pasojë shmangien e detyrimeve doganore me ndikim në buxhetin e shtetit, si operatori ekonomik rezulton që të mos ushtrojmë aktivitetet në ambientet e deklaruar ku bëhej përpunimin nën mbikëqyrjen doganore dhe asnjë përfaqësues ligjor nuk u paraqit për të marrë përsipër detyrimet ligjore që rezultojnë nga legjislacioni doganor duke iu shmangur kështu në mënyrë të hapur, përbëjnë shkelje të nenit 253, pika 1, geramat (b) dhe (c) të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 253 Kundërvajtje të kryera me dashje

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera me dashje:

b) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

c) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e

legjislacionit doganor, i detyrimit për të informuar autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor që lind pasi vendimi është marrë nga ato autoritete e që ndikon në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28.

Ne lidhje me konstatimin për mos paraqitjen e dokumentacionin të mbylljes së regjimit doganor, konstatojmë se shkelja e mësipërme është e kryer me neglizhencë, sepse sipas afate për përcaktuara në autorizimin RPA -së nr. 17708/1, datë 25.01.2023, afati i paraqitjes së dokumentit të mbylljes ishte me datën 23.08.2025, ndërkohe që rezultoi që ky subjekt të jetë pajisur me autorizimin RPA-së nr. 28714/1, datë 23.01.2024, duke neglizhuar në mënyrë të plotë detyrimet që rrjedhin nga vendimmarrja e autoriteteve doganore edhe pse vazhonte punën në regjimin e posaçëm doganor.

Subjekti “NEEFER” sh.p.k., me NIPT M27227003J, për mos paraqitjen e dokumentit të mbylljes së regjimeve doganore, ka kryer “*Shkelje administrative të kryer në neglizhencë*”, bazuar në nenin 252, pika c) e Ligjit Nr.102/2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i cili citon:

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë:

c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Për këtë “*Shkelje administrative të kryer në neglizhencë*” bazuar në nenin 257, pika 1, germa b), e cila citon si më poshtë:

1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm:

b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50.000 lekë deri në 500.000 lekë”.

Bazuar në nenin 196 pika 3 të Kodit Doganor, Autoritetet Doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e situatës për mallrat, në lidhje me të cilat një regjim nuk është mbyllur sipas kushteve të përcaktuara. Bazuar në nenin 260 të Kodit Doganor, kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas.

Përsa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër gjen të drejtë zbatimin e nenit 252, germa c, 253, germa (b,c), neni 257, pika 1, germa b, nenin 258, pika 1 germa (a) dhe të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 537 – 550 të VKM-së Nr. 651, datë 10/11/2017 “*Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.04 datë 28.03.2019 “*Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv*” dhe;

V E N D O S I:

1. Shpalljen debitor të subjektit “**NEEFER**” sh.p.k., me NIPT M27227003J, për shkeljet e konstatuara në kuadër të autorizimeve të Regjimit të Përpunimit Aktiv (RPA) nr. 17708/1, datë 25.01.2023 dhe nr. 28714/1, datë 23.01.2024, si më poshtë:

a) Për mallin e pa eksportuar:

Detyrim doganor i shmangur:	170,400 lekë
Gjobë në masën trefish të detyrimit:	511,200 lekë
Shuma: 681,600 lekë	

b) Për mbetjet teknologjike:

Detyrim doganor i shmangur:	47,040 lekë
Gjobë në masën trefish të detyrimit:	141,120 lekë
Shuma: 188,160 lekë	

c) Për mosparaqitjen e dokumentacionit për mbylljen e regjimit të RPA-së nr. 17708/1, datë 25.01.2023, në kundërshtim me nenin 252, pika (c), si dhe në zbatim të nenit 257, pika 1, germa (b) të Kodit Doganor, vendoset gjobë në shumën **50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë**.

d) Për mosparaqitjen e dokumentacionit për mbylljen e regjimit të RPA-së nr. 28714/1, datë 23.01.2024, në kundërshtim me nenin 252, pika (c), si dhe në zbatim të nenit 257, pika 1, germa (b) të Kodit Doganor, vendoset gjobë në shumën **50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë**.

- *Borxhi doganor është total në shumën 969.760 (nënte milion e gjashtëqind e nënte mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.*

- Bazuar në nenin 196 pika 3 të Kodit Doganor, ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore të marrin të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e situatës për mallrat nën Regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) nr. 17708/1, datë 25.01.2023 dhe nr. 28714/1, datë 23.01.2024 për të cilat nuk është dhënë destinacion doganor, si dhe të vendosë masa të menjëhershme dhe të përshtatshme sigurie, me qëllim parandalimin e përdorimit apo tjetërsimit të tyre nga subjekti debitor, deri në shlyerjen e detyrimeve doganore.
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet, Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Shkodër, për zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi, si dhe për raportuar në mënyrë periodike për gjendjen e mallit.
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet, Zyrës së Financës, për kontabilizimin e borxhit doganor.
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Aposteriorit/Analizës së Riskut pranë Degës së Doganës Shkodër, për pasqyrimin në sistemin ASYCUDA World dhe për veprime të mëtejshme.
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Borxhit, për ndjekjen e procedurave të rikuperimit të borxhit doganor.
- Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.

KRYETAR

Aida DIZDARI

